

# Raport Monitorues mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale, Ekonomike të të Rinjve

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- Përmbledhje
- 1 Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve
- 2 Krahasimi i të Dhënave të Monitoruara gjatë 2 viteve
- 3 Çështjet për Advokim dhe Rekomandime

## Përmbledhje

### *Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim*

**Partnerët Shqipëri** është anëtare e rrjetit rajonal “Youth Bank Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, pjesë e të cilit është fondacioni “Ana i Vlade Divac” në Serbi, shoqata për Edukim –MLADIINFO në Maqedoni, organizata “Prima” në Mal të Zi dhe fondacioni “Community Volunteers” (TOG) në Turqi.

Qëllimi i këtij raporti monitorues është të pasqyrojë gjendjen lidhur me pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve. Raporti monitorues shërben si një guidë me rekomandime për hartimin e politikave dhe iniciativave advokuese për pjesëmarrjen e të rinjve e bazuar në evidenca dhe të dhëna.

Raporti paraqet një përshkrim të shkurtër të të dhënave të përditësuara mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve bazuar në një set indikatorësh të përcaktuar. Meqënëse është viti i dytë i monitorimit, në këtë raport paraqitet një krahasim i të dhënave më të rëndësishme të monitoruara gjatë këtyre dy viteve (2016 dhe 2017), një set rekomandimesh mbi hartimin e politikave në këtë fushë dhe çështjet për iniciativa advokuese potenciale të identifikuar përmes një serie konsultimesh gjatë tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të OSHCve.

Mbledhja e të dhënave është bazuar në të dhëna sekondare nga raporte të ndryshme dhe kërkesa zyrtare për informacion drejtuar institucioneve përgjegjëse si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Bashkitë e Shqipërisë.

Në lidhje me pjesëmarrjen sociale të të rinjve, PSH realizoi një pyetësor online me OSHC që punojnë me të rinjtë dhe për çështjet e të rinjve. Qëllimi i pyetësorit ishte të analizohej pjesëmarrja e të rinjve në pozicione ekzekutive, role manaxheriale dhe organizma vendimarrës si: bordi i drejtorëve dhe asambleja e përgjithshme e OSHCve. Në total, 53 OSHC iu përgjigjën pyetësorit. Të dhënat e këtij pyetësori janë analizuar dhe paraqitur në këtë raport, shoqëruar me rekomandimet përkatëse.


Shënim: *Të rinjtë janë individë të grupmohës nga 15 deri në 29 vjeç, bazuar në përkufizimin e EUROSTAT.*

A project funded  
by the European Union



# Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

Të Rinjtë në Qeverisje



■ Të Rinj Ministra 
 ■ Të Rinj Zv. Ministra 
 ■ Të Rinj Kryetarë Bashkie 
 ■ Të Rinj Deputetë


**20%** të rinj pjesë e asamblesë së përgjithshme të Partisë Socialiste të Shqipërisë (Partia Socialiste e Shqipërisë, 2017)

**0** struktura rinore në nivel qendror

**18** nga **52** bashki të përgjigjura kanë një strukturë (Bashkitë, 2017)

<sup>1</sup> Është përzgjedhur partia politike që ka shumicën në parlament, me qëllim për të parë pjesëmarrjen e të rinjve në organizmat vendimmarrës së partive politike.


“Nga monitorimi i mjeteve/platformave online, është evidentuar se ministrinë kanë website dhe faqe në Facebook më të përditësuar sesa bashkitë. Në nivel lokal ekziston një mungesë informacioni dhe interaktiviteti midis qytetarëve dhe bashkisë”



2

## Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

Nga analiza e të dhënave të OSHCve, mesatarja e të rinjve në pozicione manaxheriale është *sa gjysma* e mesatares të numrit total të manaxherëve në një OSHC.




3

<sup>2</sup> Mjetet on-line për informacion dhe pjesëmarrje në vendimmarrje të qeverisë, parlamentit dhe bashkive. PSH ka monitoruar tre mjete/platforma online: faqet e website, llogaritë në Facebook dhe Twitter.

<sup>3</sup> 53 OSHC kanë qenë pjesë e kampionit dhe i janë përgjigjur një pyetësori të shkurtër.


Mesatarja e të rinjve anëtarë në organizmat vendimmarrës së OSHCve është sa **një e treta** e mesatares së numrit total të anëtarëve në këto organizma vendimmarrës.

### Të Rinj Anëtarë të Organizmave Vendimmarrës së OSHCve




### Të Rinj President/Drejtor Ekzekutiv në OSHC


Vetëm **14.8%** e Presidentëve /Drejtorëve të OSHCve të përgjigjura janë të rinj.



### Të Rinjtë në Universitet



4




5

<sup>4</sup> Të dhënat më të fundit të përditësuara për numrin e të rinjve të regjistruar në universitete janë për vitin akademik 2016-2017: <http://www.instat.gov.al/media/2920/nx%C3%ABn%C3%ABs-dhe-student%C3%AB-t%C3%AB-regjistruar-n%C3%AB-arsim.xlsx>  
Të dhënat më të fundit të përditësuara për numrin e të rinjve të diplomuar në universitete janë për vitin akademik 2015-2016: <http://www.instat.gov.al/media/2924/t%C3%AB-diplomuar-sipas-niveleve-arsimore.xlsx>

<sup>5</sup> Burimi për të rinjtë në risk varfërie dhe analfabetë: Të Rinjtë në Shqipëri, Sfidat në kohët që ndryshojnë (INSTAT, 2015) <http://www.instat.gov.al/media/2791/libri-t%C3%AB-rinjt%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-sfidat-n%C3%AB-koh%C3%ABt-q%C3%AB-ndryshojn%C3%AB.pdf>

Burimi për % e të rinjve në burgje është Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, 2017

## Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve



6

Burimi i informacionit për normën e braktisjes së arsimit 9 vjeçar dhe numrin e të rinjve që kanë braktisur shkollën 9 vjeçare është Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, 2017

<sup>6</sup>Norma e Papunësisë së të Rinjve, Norma e Personave jo në Punësim, Arsim dhe Trajnim, Norma e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës së të Rinjve, Norma e Punësimin të të Rinjve (INSTAT, 2016)  
Norma e Papunësisë Afatgjatë të të Rinjve (INSTAT, 2015)

## Krahasimi i të Dhënave të Monitoruara gjatë 2 viteve

*Përsa i përket pjesëmarrjes politike të të rinjve*, situata nuk ka ndryshuar në numrin e ministrave të rinj (ka mbetur 0), pavarësisht se përfaqësuesit e qeverisë kanë ndryshuar gjatë këtyre dy viteve monitorim. Ka një rritje të vogël në përqindjen e deputetëve të rinj në parlament, nga 2% në 6%.

Nga ana tjetër, ka një mungesë të Bordeve Rinore Këshillimore në ministri dhe nuk ka ndodhur asnjë ndryshim gjatë këtyre dy viteve monitorim, çka evidenton pjesëmarrjen e ulët të të rinjve në vendimmarrjen në nivel qendror. Megjithëse krijimi i Bordit Rinor Këshillimor pranë ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ishte një nga aktivitetet e planifikuara për 2015,<sup>7</sup> deri më sot një bord i tillë nuk është krijuar. Pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë ishte dhe krijimi i Bordeve Rinore Këshillimore në nivel lokal. Nga monitorimi vihet re një rritje e numrit të strukturave rinore pranë bashkive. Të pyetura për Bordet Rinore Këshillimore, 18 nga 52 bashki të përgjigjura shprehën se kanë krijuar një strukturë të tillë. Ndërkohë, disa bashki të tjera që ende nuk kanë një strukturë shprehën vullnetin dhe dëshirën për të ngritur një Bord Rinor Këshillimor me mbështetjen e OSHCve dhe donatorëve.

Në termat e mjeteve online të përdorura për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, evidentohet një rritje në numrin e bashkive që kanë krijuar një website ose faqe në Facebook gjatë 2016-2017.

*Lidhur me pjesëmarrjen sociale të të rinjve*, ka një rënie me 4.8% të të rinjve të regjistruar në universitete, dhe një rënie me 6% të të rinjve të diplomuar nga universiteti. Një e dhënë, e cila është përkeqësuar është numri i të rinjve në burgje<sup>8</sup>, i cili është 10% më i lartë sesa viti i shkuar.

*Përsa i përket pjesëmarrjen ekonomike të të rinjve*, norma e papunësisë së të rinjve ka një rënie me 4.3%. Nga ana tjetër, gjatë 2017 përqindja e të rinjve kundrejt numrit total të personave të vetëpunësuar është ulur me 10% në krahasim me vitin 2016. Ka një rënie totale në numrin e personave që kanë përfituar mbështetje financiare nga shteti për start-upet (nga 18<sup>9</sup> në 0 të rinj).

<sup>7</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 (Këshilli i Ministrave Nr. 383, 2015)

<sup>8</sup> Përqindja e të rinjve në burgje është llogaritur si numri i të rinjve në burg kundrejt numrit total të të burgosurve në Shqipëri

<sup>9</sup> Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (2016), 18 të rinj nga 33 persona kanë përfituar mbështetje financiare nga shteti për start-up. Ndërkohë, gjatë vitit 2017 asnjë person nuk ka përfituar mbështetje financiare nga shteti për start-up.

## Çështje për Advokim dhe Rekomandime

Bazuar në konsultime me përfaqësues të OSHCve gjatë një serie tryezash të rrumbullakëta rajonale të organizuara nga PSH janë identifikuar disa çështje advokacie lidhur me pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve.

### **Pjesëmarrja Politike e të Rinjve**

- Partitë politike duhet të përmirësojnë qasjen e tyre për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe demokratike;
- Duhet të rritet pjesëmarrja e të rinjve në pozicione ekzekutive në nivel lokal dhe qendror;
- Bazuar dhe në objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë është e rëndësishme të krijohet Bordi Rinor Këshillimor në nivel qendror, si dhe të rritet numri i Bordeve Rinore Këshillimore në nivel lokal. Sipas OSHCve, krijimi i strukturave rinore në nivel lokal duhet të përcaktohet me ligj dhe është e nevojshme të fuqizohen këto struktura rinore përmes mbështetjes financiare nga donatorë dhe shteti në bashkëpunim me OSHCtë lokale.

### **Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve**

- Arsimi është fusha kryesore që ka nevojë për ndërhyrje, përmes përshtatjes së kurrikulave për arsimin fillor dhe 9 vjeçar, duke përfshirë aktivitete ekstrakurrikulare si klube sportive, arti, ku të rinjtë mund të ndajnë interesat dhe pasionet e përbashkëta dhe mund të angazhohen në jetën sociale, duke i mbajtur të rinjtë larg krimit dhe aktiviteteve të paligjshme. Me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe njëkohësisht aftësive për jetën, duhet të krijohen klube sociale dhe debati në shkollat e mesme;
- Më shumë fokus duhet t'i kushtohet këshillimit të karrierës, veçanërisht krijimit të qendrave të këshillimit të karrierës në shkollat e mesme duke vënë në dispozicion staf profesional dhe të kualifikuar për të ofruar këshillimin;
- Duhet të rritet numri i hapësirave publike të dedikuara për aktivitete rinore sportive dhe kulturore;
- Programet e riintegritimit duhet të përshtaten për të rinjtë në burgje, sipas nevojave dhe situatës së tyre. Këto programe duhet të kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve të të rinjve në aftësitë e ndryshme për jetën dhe trajnimin profesional, duke i përgatitur ata për jetën jashtë burgut;
- Duhet të krijohen skema mbështetëse të dedikuara për emigrantët e rikthyer, si për shembull duke krijuar mundësi të reja punësimi, ofrimin e granteve për start-up, trajnime



profesionale, njehsimin e çertifikatave të marra nga jashtë, ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët dhe të rinjtë që kanë vështirësi të përshtaten në shkollë etj.

### **Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve**

- Një nga çështjet për advokim është reduktimi i nivelit të lartë të papunësisë, përmes fuqizimit të mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në mundësitë e punësimit, investimin në më shumë mjete online informimi dhe shërbime profesionale që mundësojnë krijimin e aftësive lidhur me punën;
- Krijimi i qendrave të këshillimit të karrierës jo vetëm në universitete, por dhe në shkolla të mesme përbën një prioritet dhe përsa i përket pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve. Kjo duhet të shoqërohet me më shumë studime për tregun e punës, me qëllim informimin e studentëve për profesionet e ardhshme, duke bërë të mundur përputhjen e pasioneve të tyre me nevojat e tregut;
- Duhet të rritet numri i shkollave profesionale në Shqipëri dhe të promovohet më shumë arsimit profesional, me qëllim që të rinjtë të drejtohen drejt këtij arsimit. Njerëzit me nivel të ulët arsimor e kanë të vështirë të gjejnë një punë, por po kështu ndodh dhe me personat me arsim të lartë, duke qenë se nuk ka mundësi punësimi që përputhen me nivelin e tyre të pritshmërive dhe aftësive.
- Duhet të krijohet një mjedis mundësues për zhvillimin e biznesit të vogël, ndërtimin e aftësive sipërmarrëse si dhe lehtësimin e marrjes së kredive. Mungesa e fondeve për start-up<sub>e</sub> të ofruara nga shteti mbetet një çështje që ofron mundësi të kufizuara për sipërmarrësit e rinj. Nuk duhet thjesht të krijohen më shumë skema mbështetëse për start-up<sub>et</sub>, por dhe të promovohen më shumë duke targetuar të gjithë të rinjtë sipërmarrës ekzistues dhe potencialë.